



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. 26/2025

Data: 01 prill, 2025. Ora: 13:30

Vendi: KQZ/ Prishtinë

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban.

Në takim ishin të pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ Nr. 21, 22 dhe 23/2025

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të SKQZ për pagesën e orëve në pritje të tejkaluara në transportimin e materialit zgjedhor dhe jo zgjedhor për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës 2025

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës “Mësimet e nxëna nga Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025”

4. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së: Kryetari Radoniqi, paraqiti përmbajtjen e mbledhjes. Besnik Buzhala, u.d i Sekretariatit tha se, e kemi një rekomandim për autorizim e drejtorit lidhur me nënshkrim të marrëveshjeve. Është marrëveshja me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale lidhur me shërbimet e Prokurimit. Kemi pasur një marrëveshje njëvjeçare, dhe kjo marrëveshje ka skadue. Kërkojmë që kjo të jetë pika e katërt e mbledhjes.

Me 9 vota për, miratohet rendi i ditës. Miratohet edhe procesverbalet, me 1 votë kundër (anëtar: Sami Kurteshi).

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të SKQZ për pagesën e orëve në pritje të tejkaluara në transportimin e materialit zgjedhor dhe jo zgjedhor për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës 2025:

Besnik Buzhala: Është një rekomandim për pagesën e orëve në pritje-të tejkaluara për transportimin e materialit zgjedhor dhe jo zgjedhor për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës 2025. KQZ, ka lidhur marrëveshje me operatorin ekonomik “En logistic” për dy palë zgjedhje në vlerë prej 120, 000 euro. Lidhur me zgjedhjet për Kuvend të mbajtura më 9 shkurt, z. Buzhala paraqiti një raport të detajuar se, pse kësaj kompanie duhet bërë pagesa e “orëve në pritje”! Pas këtij raportimi, z. Buzhala tha se Sekretariati rekomandi që operatorit me të cilën kemi kontratë, t’i paguhet 17, 983 euro për “120 orë shtesë”.

Sami Kurteshi: Po thuhet “në pritje”...?

Besnik Buzhala: I bie që vlera e orës ka qenë “143 euro” për një mjet transportues. Bëhet fjalë për faktin se me datën “8 shkurt, 2025” nga operatori janë realizuar orë në pritje (rreth orës 22: 00 në mbrëmje – deri në mëngjes), lidhur me bartjen e materialit. Kjo, është e paraparë edhe me kontratë. Ora e orëve në pritje që rekomandojmë për pagesë, është “149,80 euro”.

Në këtë pikë, diskutuan: **Alban Krasniqi**, i cili tha se ka qenë një kontratë e dëmshme, dhe nuk dimë sa orë është pritur, nuk shkruan...! Kjo, i vjen sikur vetë operatori me pas shpallë tender, dhe sikur vet me i pas qitë kushtet për vete... Unë, se votoj, tha z. Krasniqi, dhe auditori menjëherë ta auditoj këtë kontratë...

Kreshnik Radoniqi: A ka evidenca të pritjes, a ka...?

Besnik Buzhala: Po, ka.

Sami Hamiti: Ma shtrenjtë po i bje pagesa për pritje, se pagesa e vozitjes...!

Ilir Gashi: Ajo që është në kontratë dhe në specifika, e që është nënshkrua, ne tani s’kemi çka të bëjmë, mirëpo nëse kontrata është e pavoritshme, të shkëputet kontrata...

Alban Krasniqi: Nuk ka logjikë me qenë më shtrenjtë orët e pritjes, se sa ato të vozitjes...! KQZ nuk ban specifika, si ka mundësi...?

Diskutimet nuk kuptohen, bëhen pa rend mes anëtarëve, drejtorit, drejtorit të DOZ etj.

Kreshnik Radoniqi: Vazhdojmë me pikën e radhës, këtë pikë ose e heqim nga rendi i ditës, ose i kthehem përsëri...

3. Këshlli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës “Mësimet e nxëna nga Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025”:

Gordana Llaban: Në takimin e sotëm të buxhetit, kemi shqyrtuar pikën lidhur me organizimin e analizës së KQZ-së me temën: “Mësimet e nxëna nga Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025”, që parashihet të mbahet prej: 4-7 prill. Parashihet të marrin pjesë 30 persona: 11 anëtarë të KQZ-së, dhe 19 nga Sekretariati. Shpenzimet janë: 15, 620 euro.

Diskutuan: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi.

Me 8 vota për, 1 abstenim u miratua punësoria që do të mbahet në Tiranë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i autorizimit të Drejtorit për lidhje të marrëveshjeve me palët e treta

Besnik Buzhala: Mendojmë që ta vazhdojmë ti marrim shërbimet e prokurimit me KPMM, deri sa ta zgjedhim këtë çështje. Prandaj, rekomandojmë që kjo të miratohet...

Diskutuan: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Besnik Buzhala.

Me 9 vota për, miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Pikën për pagesë të “orëve në pritje” e tërheqim...

Të ndryshme !

